

URDHËR
Nr. 449, datë 22.5.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të germës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të germës “c”, të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi;

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave znj. Jonida Brati, drejtoreshë e Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit Tekniko-Ligjor, për sa vijon:

- Për të nënshkruar aktet e ndërmjetme që i paraqiten gjykatës, lidhur me proceset gjyqësore të ndjekura nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar nga drejtori i përgjithshëm, si: deklaratat mbrojtjeje, parashtrime, prapësime, konkluzione përfundimtare, kërkesa për shtim/saktësim objekti, apo kërkesa të tjera procedurale gjatë zhvillimit të gjykimit, pjesë e fushës së përgjegjësisë së Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit Tekniko-Ligjor, që i paraqiten gjykatës në funksion të zhvillimit dhe ecurisë së proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit;

- Për të nënshkruar shkresat me karakter njohës dhe informues, dalëse të Drejtorisë së Përgjithshme, pjesë e fushës së përgjegjësisë së Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit Tekniko-Ligjor që u drejtohen të tretëve (personat fizikë, persona juridikë privatë), si dhe ato të drejtuara strukturave të varësisë së ASHK-së në funksion të informimit të të tretëve.

2. Pavarësisht delegimit të kompetencave sipas këtij urdhri, drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit Tekniko-Ligjor, nëse e gjykon të nevojshme, mund t'i përcjellë për nënshkrim drejtorit të përgjithshëm aktet që i vlerëson të një rëndësie të veçantë.

3. Delegimi i kompetencës sipas këtij urdhri nuk përfshin nënshkrimin e autorizimit për përfaqësim gjyqësor, ankimet, rekursat apo aktet administrative dhe detyrat të cilat duhet të miratohen dhe të ushtrohen nga drejtori i përgjithshëm, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”.

4. Në rast mungese në detyrë të drejtorit të Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit Tekniko-Ligjor, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës, në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “c”, e Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë mungesës kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.

5. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri, të ushtrohet duke filluar nga data e miratimit të këtij urdhri deri në shfuqizimin e tij.

6. Urdhrat nr. 226, datë 6.3.2026 dhe nr. 51, datë 14.1.2026, të drejtorit të përgjithshëm, shfuqizohen.

7. Ngarkohet znj. Jonida Brati, Drejtoria Juridike dhe e Kontrollit Tekniko-Ligjor dhe Sektori i Arkiv Protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli